

KONTRATAT KOMERCIALE NDËRKOMBËTARE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Kontratat komerciale ndërkombëtare
Niveli:	Master (LL.M.) në kontrata dhe të drejten komerciale
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Semestri:	II
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E marte: 15.00 - 17.15
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr.iur. Bashkim Preteni
Detajet kontaktuese:	bashkim.preteni@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda “Kontratat Komerciale Ndërkombëtare” përfshin rregullat bazë në fushën e transaksioneve juridike ndërkombëtare. Ajo ofron një analizë të thelluar të kontratave komerciale ndërkombëtare, duke u fokusuar në kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet palëve nga shtete të ndryshme. Studentët do të njihen me Konventën e Kombeve të Bashkuara për Kontratat e Shitjes Ndërkombëtare të Mallrave (CISG), rregullat e UNIDROIT për kontratat tregtare ndërkombëtare, Principet Evropiane të Kontraktimit dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshirë arbitrazhin dhe gjyqësorin ndërkombëtar. Një vend i rëndësishëm i kushtohet edhe zbatimit të këtyre rregullave në sistemin e brendshëm juridik të Kosovës dhe vendimarrjes së Gjykatës Komerciale në rastet e kontesteve tek kontratat komerciale ndërkombëtare. Përmes analizave teorike dhe studimeve të rasteve, studentët do të zhvillojnë aftësi për të interpretuar dhe negociuar kontrata ndërkombëtare, duke marrë parasysh standardet dhe praktikat më të mira në tregtinë globale.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e lëndës janë që studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë parimet dhe rregullat themelore të kontratave komerciale ndërkombëtare dhe rolin e tyre në sistemet juridik; - Identifikojnë dhe analizojnë burimet e detyrimeve tek kontratat komerciale ndërkombëtare, duke përfshirë negociatat, formimin e kontratave, përmbushjen e detyrimeve dhe shuajren e detyrimeve; - Zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike në

	<p>interpretimin e dispozitave ligjore, klauzolare kontraktuale dhe zbatimin e tyre në praktikë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasojnë dhe vlerësojnë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet legjislacionit vendor, të drejtës komperative dhe rregullave ndërkombëtare në fushën kontratave komerciale ndërkombëtare (CISG); - Kuptojnë dhe aplikojnë parimet e përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore në rastin e kontratave komerciale ndërkombëtare; - Përvetësojnë teknikat e hartimit dhe analizës së kontratave, duke vlerësuar pasojat juridike të dispozitave kontraktore; - Zbatojnë njohuritë e fituara për të ofruar zgjidhje juridike në raste të ndryshme të tregtisë ndërkombëtare; - Përgatiten për sfidat profesionale, duke zhvilluar shkathtësi për interpretimin dhe zbatimin e normave juridike dhe obligimeve kontraktore në fushën e kontratave komerciale ndërkombëtare.
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegoj dhe analizoj konceptet dhe parimet themelore të kontratave komerciale ndërkombëtare; - Identifikoj dhe krahasoj zbatimin e rregullave nga fusha e kontratave komerciale ndërkombëtare; - Zbaton normat juridike për të zgjidhur çështje praktike në fushën e kontratave komerciale ndërkombëtare, si interpretimi i kontratave dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. - Analizon dallimet ndërmjet përgjegjësisë kontraktore dhe jashtëkontraktore në rastet e kontratave komerciale ndërkombëtare, si dhe mënyrat e kompensimit të dëmit; - Përdorë qasjen krahasimore për të vlerësuar ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet legjislacionit vendor, të drejtës krahasuese dhe instrumenteve juridike në fushën e kontratave komerciale ndërkombëtare; - Harton dhe interpretojnë kontrata komerciale ndërkombëtare për nevojat e tregtisë ndërkombëtare, duke vlerësuar pasojat juridike të dispozitave kontraktore; - Zhvillon aftësi analitike dhe kritike në shqyrtimin e rasteve praktike dhe jurisprudencës relevante në fushën e kontratave komerciale ndërkombëtare;

	- Vlerëson dhe aplikon mekanizmat e mbrojtjes juridike, përfshirë zgjidhjen e konflikteve përmes negociatave, ndërmjetësimit, arbitrazhit dhe procedurave tjera gjyqësore.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Total
Ligjeratë	3	1/15	45
Ushtrime	1	1/15	15
Kontakti me mësimdhënësin (konsultimet)	1	1/15	15
Vizita studimore	3	2/2	6
Kollokviume	3	2/2	6
Detyrë shtëpie	2	10/5	20
Projekte, zgjidhje e rasteve, prezantime, etj.	1	15/15	15
Simulim i rasteve	3	1/1	3
Totali	5 ECTS	Totali	125

Metodologjia e mësimdhënies:

Lënda do të zhvillohet përmes një kombinimi të metodave të ndryshme mësimore, të cilat synojnë të sigurojnë një përvetësim të thelluar të njohurive dhe zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike të studentëve. Metodologjia përfshin:

- Ligjëratat interaktive (Prezantimi i koncepteve kryesore dhe parimeve të së drejtës së detyrimeve përmes shpjegimeve teorike dhe ilustrimeve praktike);
- Diskutimet në klasë (Nxitja e analizës kritike dhe debatit mbi çështje të ndryshme juridike, me fokus në problematika reale dhe sfida praktike);
- Studimi i rasteve (Analizimi i vendimeve gjyqësore dhe çështjeve të rëndësishme juridike për të kuptuar zbatimin e normave ligjore në praktikë);
- Puna në grupe (Bashkëpunimi i studentëve për të zgjidhur detyra dhe ushtrime praktike, duke zhvilluar aftësi për punën ekipore dhe argumentimin ligjor);
- Ushtrime praktike (Simulime të rasteve gjyqësore dhe hartimi i kontratave për të përmirësuar aftësitë e analizës dhe interpretimit ligjor);
- Kërkimi dhe analiza juridike (Angazhimi i studentëve në hulumtime mbi tema të caktuara për t'i aftësuar ata në përdorimin e burimeve ligjore dhe

	<p>doktrimore);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantime studentore (Paraqitja e temave të veçanta nga studentët për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe argumentimit juridik).
Poentimi dhe vlerësimi:	<p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi i vazhdueshëm:</u></p> <p>Pikët në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjidhja e rasteve dhe angazhimet tjera në klasë dhe në shtëpi 20 pikë; - Testi i parë 40 pikë; - Testi i dytë 40 pikë. <p>Studentët që arrijnë rezultat pozitiv përmes vlerësimit të vazhdueshëm lirohen nga provimi. Vlerësimi i vazhdueshëm përfundon në muajin Maj 2025.</p> <p>Nota e fituar me anë të vlerësimit të vazhdueshëm ruhet deri në afatin e Shtatorit 2025. Me rastin e hyrjes në provim humb nota e fituar me anë të vlerësimit të vazhdueshëm.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi në provimin final:</u></p> <p>Studentët që nuk arrijnë sukses përmes vlerësimit të vazhdueshëm hyjnë në provimin final. Provimi final ka gjithsej 80 pikë, kurse 20 pikët e cekura më lartë (zgjidhja e rasteve dhe angazhimet tjera) numërohen dhe transferohen në provimin final.</p>
Notimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Deri në 50 pikë = Nota 5 (pesë); - Mbi 50 pikë = Nota 6 (gjashtë). - Mbi 60 pikë = Nota 7 (shtatë); - Mbi 70 pikë = Nota 8 (tetë); - Mbi 80 pikë = Nota 9 (nëntë); - Mbi 90 pikë = Nota 10 (dhjetë).
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Joseph Lookofsky, Convention on Contracts for the International Sale of Goods – CISG (Kluwer Law International); - Konventa për Shitjen ndërkombëtare të Mallrave – CISG (e përkthyer në gjuhën shqipe); - Unidroit Principles of International Commercial Contracts (2016); - The Principles of European Contract Law - PECL; - Draft Common Frame of Reference – DFCR;
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkim Preteni, Contract law in Kosovo in International Encyclopaedia of Laws – Contracts, published by Wolters Kluwer (Netherlands, 2024). - Vjosa Osmani, Treaty Application in Kosovo through rules of Succession and as Domestic Law: The Example of

	the CISG.
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantim dhe diskutim mbi syllabusin; - Kuptimi dhe terminologjia e lëndës; - Sistematizimi i lëndës; - Zhvillimi historik i kontratave komerciale ndërkombëtare; - Kontratat komerciale ndërkombëtare në kohën moderne.
<i>Java e dytë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Mbi CISG-un në përgjithësi; - Fusha e zbatimit; - Aplikimi i CISG-ut në Kosovë; - Dispozitat e përgjithshme; - Ndikimi i CISG-ut në tregtinë ndërkombëtare.
<i>Java e tretë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i kontratës sipas CISG; - Zhvillimi i negociatave sipas CISG; - Oferta dhe pranimi i ofertës sipas CISG; - Lidhja e kontratës sipas CISG.
<i>Java e katërt:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Detyrimet e shitësit sipas CISG-ut; - Detyrimet e blerësit sipas CISG-ut; - Diksutim dhe zgjidhje e rasteve studimore.
<i>Java e pestë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Detyrimet e shitësit sipas CISG-ut; - Detyrimet e blerësit sipas CISG-ut; - Detyrimet e përbashkëta të blerësit dhe shitësit sipas CISG; - Diksutim dhe zgjidhje e rasteve studimore.
<i>Java e gjashtë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i një kontrate komerciale ndërkombëtare; - Specifikat e rastit shkruhen nga profesori; - Studentët ndahen në grupe dhe draftojnë dispozita kontraktuale në përputhje me specifikat e rastit të dhënë nga profesori; - Përfaqësuesi i secilit grup prezanton punën grupore.
<i>Java e shtatë:</i>	<p style="text-align: center;"><u>Testimi i parë i studentëve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Testimi i parë i ka gjithsej 40 pikë; - Për të marrur pjesë në testimin e parë është e domosdoshme pjesëmarrja në së paku 5 ligjërata; - Në testimin e parë lejohet përdorimi i ligjeve në formë fizike (të printuar). Nuk lejohet përdorimi i materialeve shkencore; - Studenti duhet të arrijë së paku 21 pikë për tu konsideruar se ka arritur vlerësim pozitiv dhe të hynë

	në testimin e dytë.
Java e tetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Mjetet juridike në dispozicion të blerësit sipas CISG lidhur me përmbushjen e detyrimeve; - Mjetet juridike në dispozicion të shitësit sipas CISG lidhur me përmbushjen e detyrimeve.
Java e nëntë:	<ul style="list-style-type: none"> - Dëmi kontraktor sipas CISG; - Llojet e dëmit sipas CISG; - Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit sipas CISG; - Lirimi nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit sipas CISG; - Pagesa e interesave tjerë financiar sipas CISG.
Java e dhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Vizitë studimore në Gjykatën Komerciale të Kosovës për tu njoftuar lidhur me praktikën gjyqësore në fushën e kontratave komerciale ndërkombëtare; - Vizita koordinohet me Këshillin Gjyqësor të Kosovës; - Gjyqtarët bëjnë një prezantim lidhur me praktikën gjyqësore.
Java e njëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në parimet e UNIDROIT për kontratat komerciale ndërkombëtare; - Rëndësia e parimeve të UNIDROIT për kontratat komerciale ndërkombëtare; - Zbatimi i parimeve të UNIDROIT për kontratat komerciale ndërkombëtare;
Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Parimet evropiane të të drejtës kontraktore - PECL; - Drafti i Përbashkët Kornizë i Referencave (DCFR); - Ndikimi i këtyre rregullave në kontratat komerciale ndërkombëtare.
Java e trembëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Zgjidhja e mosmarrëveshje në rastet e kontratave komerciale ndërkombëtare; - Negocimi si formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; - Arbitrazhi si formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
Java e katërbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Simulim nga studentët i një seance të arbitrazhit komercial.
Java e pesëmbëdhjetë:	<p style="text-align: center;"><u>Testimi i dytë i studentëve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Testimi i dytë i ka gjithsej 40 pikë; - Për të marrur pjesë në testimin e parë është e domosdoshme pjesëmarrja në së paku 5 ligjërata pas mbajtjes së vlerësimit të parë; - Vetëm studentët që kanë arritur vlerësim pozitiv në testimin e parë (21 pikë) mund të marrin pjesë në testimin e dytë; - Në testimin e dytë lejohet përdorimi i ligjeve në formë fizike (të printuar). Nuk lejohet përdorimi i materialeve shkencore;

Konsultimet

- Konsultimet mbahen secilen javë (e marte, e mërkure dhe e enjte);
- Secili student mund të kërkon takim virtual apo në fakultet për konsultime lidhur me lëndën duke i shkruar email profesorit të lëndës;
- Profesori cakton orarin e konsultimeve brenda javës sipas radhës së paraqitjes së kërkesave të studentëve.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti gjatë pjesëmarrjes në ligjërata, testime dhe provime duhet:

- Të respekton kodin e veshjes;
- Të komunikon me respekt dhe mirësjellje me profesorin dhe studentët tjerë;
- Të mos përdorë telefonin dhe paisjet tjera teknologjike;
- Të respekton udhëzimet akademike;
- Të mos kryej regjistrime të paautorizuara;
- Të mos përdorë forma dhe mënyra tjera të papërshtatshme gjatë testimit të njohurive.